



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 58, datë 30.06.2020

PËR MIRATIM REZOLUTE
“MBI MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA PËR SHKAK TË SITUATËS SË
KRIJUAR SI REZULTAT I PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19, PËR
PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE”

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma “b”, nenin 54, shkronja “k”, 55, pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 83 i Rregullores se Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, dhe sipas relacionit të për gatitur nga Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënien Sociale, me propozim të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënien Sociale,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e Rezolutës, bashkëngjitur këtij vendimi .
2. Kjo Rezolutë i dërgohet Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Prefektit të Qarkut .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.07.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI I BASHKISË

Komisioni i Përhershëm për Barazinë Gjinore dhe Mirëqënien Sociale

REZOLUTË

**MBI MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR
SI REZULTAT I PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19, PËR
PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE.**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Durrës”, duke marrë në konsiderate rolin e Këshillit Bashkiak, si organi mbikqyrës të Njësisë së Qeverisjes Vendore (Bashkia Durrës), si përfaqësues i vullnetit të qytetarëve të Durrësit;

- Duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar në vendin tonë për shkak të COVID-19;
- Duke qenë të vetëdijshëm, që pandemia amplifikon pabarazitë ekzistuese në drejtim të të drejtave mes grave dhe burrave dhe grupeve të ndryshme sociale, gratë e dhunuara, të identifikuar më herët janë veçanërisht të rrezikuara.
- Duke marrë në konsiderate masat parandaluese dhe ato që vijnë në ndihmë të grupit të grave të dhunuara, Këshilli Bashkiak synon të nxisë dhe mbështesë masa lokale të adaptuara, të cilat janë gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe të drejta, përmes vënies në efikasitet të strukturave dhe burimeve ekzistuese që kanë bashkitë, bazuar në ligjin me poshtë, por jo vetëm:

Ligji Nr. 47/2018 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR:

- Duke vlerësuar të domosdoshme, marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si pasoje e pandemisë nga epidemia COVID-19;
- Duke vlerësuar se viktimat e dhunës në familje janë më të rrezikuara dhe mund të jenë pa mundësi marrje shërbimi;
- Duke vlerësuar përgjegjësitë e bashkisë, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji

Këshilli Bashkiak Durrës, i kërkon Kryetarit/es së Bashkisë Durrës:

- Të vërë në efincë strukturat dhe burimet ekzistuese përkatëse për të kontaktuar rastet e dhunuara.
- Koordinatorët/et Vendorë/e të raportojnë një herë në javë pranë komisionit të barazisë gjinore dhe të mirëqënies sociale (KBGjMS) për numrin e viktimave të dhunës të kontaktuara, si masë parandaluese për dhunën.
- Të ndërmarrë fushata informuese rreth parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe njohjes së mekanizmave mbrojtës që mund të arrihen dhe të përdoren nga viktimat duke ruajtur sigurinë e tyre.

Komisioni I Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale

Klementina Meçi

Kryetar i Komisionit (PRO)

Petrit Ismailati

Zv/Kryetar

(PRO)

Jolanda Mustafaraj

Sekretare

(PRO)

Esmeralda Xheraj

Anëtar

(PRO)

Adriana Hatellari

Anëtar

(PRO)




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 586 / prot.
5



Durrës, më 06.07. 2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.58 datë 30.06.2020 Për miratim Rezolutive “Mbi marrjen e masave të veçanta për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, për parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

